

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Three Folks”SHPK

Bazuar ne kerkesat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “Per shoqerite Tregtare”formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emeruar **“Three Folks”** shpk ,ne Tirane, sot me daten 25 Nentor 2019 e ortakeve themelues :

1. **Armando Ndreu** , i biri i Ndreut dhe i Zojes , lindur ne Gjegjan-Puke dhe banues ne Tirane , i datelindjes 24 Shtator 1990 me Id J 00924101 J.
- 2.**Dorjan Myftari**,i biri i Pjetrit dhe i Lules,lindur ne Fushe Arrez,Puke dhe banues ne Tirane,i datelindjes 13 Dhjetor 1994 me ID J 41213045 Q.
3. **Anarilda Bregu**, e bija e Nazmiut dhe Habibe ,lindur ne Polican –Skrapar dhe banuese ne Tirane ,e datelindjes 30 Nentor 1989 me ID I 96130006 A.

<u>NENI 1</u>	<u>EMERTIMI I SHOQERISE</u>
1/1	- Emertimi i shoqerise eshte “Three Folks”Shpk.
½	-Selia e shoqerise eshte ne Tirane , Rruga “Mustafa Matohiti”,nr 10,Tirane,pasuri me numer 2/146,zona kadastrale 8160,Volumi 14 ,faqe 144.
1/3	-Shoqeria mund te krijoje filiale, zyra perfaqesimi dhe te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashtë shtetit, ndersa leja e ushtrimit te profesionit do te nxirret ne rrethin ku ka seline qendrore personi juridik.

<u>NENI 2</u>	<u>OBJEKTI I SHOQERISE</u>
2/1	Objekti i shoqerise: Bar-Kafe,Snack,Restorant.Import-Export mallra te ndryshme industriale dhe ushqimore si dhe cdo aktivitet tjeter te lejuar me ligj.

<u>NENI 3</u>	<u>REGJIMI JURIDIK</u>
3/1	-Shoqeria eshte me pergjegjesi te kufizuar dhe i nenshtrohet Aktit te Themelimit, Statutit, Ligjit “Per Shoqerite Tregetare” dhe Legjisacionit Shqiptar.
3/2	-Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga momenti i regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit(QKB). Shoqeria peginjet me te gjitha aktivet e saja per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtarite e ushtruara, deri ne vleren e kontributeve te nenshkruara nga ortaket.
<u>NENI 4</u>	<u>KOHEZGJATJA E SHOQERISE</u>
4/1	-Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj deri ne vitin 2060, me te drejtë zgjatje te afatit, ose zgjidhje parakohe, sipas vendimit unanim te asamblese se ortakeve.
<u>NENI 5</u>	<u>KAPITALI THEMELTAR - ASAMBLEJA</u>
5/1	<ul style="list-style-type: none"> - Kapitali themeltar eshte 100 000 (Njeqindmije) leke i ndare : 1.Armando Ndreu me kontribut 1 kuote ,1 kuote e barabarte me 33 333 leke ose gjithsejt 33.333 % e kuotave te kapitalit themeltar. 2.Dorjan Myftari me kontribut 1 kuote,1 kuote e barabarte me 33 334 leke ose gjithsejt 33.334 % e kuotave te kapitalit themeltar 3.Anarilda Bregu me kontribut 1 kuote,1 kuote e barabarte me 33 333 leke,ose gjithsejt 33.333 % e kutave te kapitalit themeltar.

5/2	<p>-Kuotat e kapitalit themeltar mund te fitohen ose kalohen nepermjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Kontributit ne Kapitalin e Shoqerise b) Shit-blerjes c) Trashegimnise c) Dhurimit
5/3	<p>-Bashkeshorti, trashegimtari behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar, vetem pasi te jene miratuar nga ortaket.</p>
5/4	<p>-Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen te treteve qe nuk bejne pjesa ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve, qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve, dhe nese shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda 3 muajve, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket brenda 3 muajve duhet t'i blejne, apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar.</p>
5/5	<p>-Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt notarial.</p>
5/6	<p>-Ortaket shlyejne ne kohe, si kontributet ne natyre, ashtu dhe ne para. Ata nuk mund te perfaqesojne kontribute ne sherbime.</p>
5/7	<p>-Kapitali themeltar ndahet ne pjesa te barabarta, vlera nominale e te cilave eshte 1000 leke.</p>
5/8	<p>-Zmadhimi i kapitalit themeltar me ane te kontributeve ne natyre mund te behet pasi ato te vleresohen nga nje ekspert per kontributet, i emeruar me unanimitetin e ortakeve, ose me vendim gjyqi, sipas kerkeses se njerit prej ortakeve. Por ortaket mund te vendosin me unanimitet qe te mos drejtohen tek nje ekspert per kontributet, neqoftese vlera e cdo kontributi ne natyre nuk tejkalon vleren e kapitalit minimal te vlefshem per krijimin e shoqerise, dhe neqoftese vlera e per gjithshme e bashkesise se kontributeve ne natyre nuk tejkalon gjysmen e kapitalit themeltar.</p>
5/9	<p>-Zvogelimi i kapitalit themeltar lejohet nga asambleja e ortakeve me vendim te ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar. Zvogelimi prek ortaket ne te njejen mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.</p>
5/10	<p>-Ne rast se kapitalet e veta te shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare, rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket vendosin brenda 4 muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne kete humbje, mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise.</p>
NENI 6	<u>TE DREJTAT E SHOQERISE DHE ORTAKEVE</u>
6/1	<p>-Shoqeria ka te drejte te lidhe kontrata dhe te nenshkruaje marreveshje brenda dhe jashte vendit.</p>
6/2	<p>-Shoqeria ka te drejte te marre pjesa si ortak ne shoqeri te tjera.</p>
6/3	<p>-Shoqeria perggijet ndaj te treteve, vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur, duke u perjashtuar perggjegjesia personale e cdo ortaku.</p>
6/4	<p>-Ortaket perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.</p>
6/5	<p>-Shoqeria nuk prishet kur falimenton ose shfaq paaftesi njeri prej ortakeve. Ajo nuk prishet kur vdes nje ortak.</p>
6/6	<p>-Ortaku ka te drejte te marre ne cdo moment raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore per pese vitet e fundit financiar, duke qene i ndihmuar po te jete nevoja, nga nje ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i neshtrohet detyrimtit per ruajtjen e sekretit profesional.</p>

6/7	-Ortaket individualisht ose ne grup, kane te drejte te ngrrene padi kundra administratorevet per shlyerjen e demit, ose padi penale. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje kerkese padine kunder administratoreve.
6/8	-Nje ose disa ortake qe perfaqesojne te pakten 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar, mund te kerkojne ne rruge gjyqesore caktimin e nje eksperti per paraqitjen e nje raporti per nje ose disa vendime administrative.
6/9	-Nje shoqeri me pjesemarrje te investimeve te huaja ka te drejte te punesoje edhe shtetas te huaj.
NENI 7	<u>DETYRAT E ORTAKEVE</u>
7/1	-Ortaket detyrohen te depozitojne kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.
7/2	-Cdo ortak detyrohet te siguroje ne kohe dhe plotesisht detyrimet e tija ndaj shoqerise dhe ortakeve te tjere.
7/3	-Kur ortaku nuk i pergjigjet detyrimeve, atehere ortaku tjeter, pasi e ka njoftuar dhe nuk ka plotesuar detyrimin, kerkon demshperblimin.
7/4	- Cdolloj iniciative ose vendimi do te konsiderohet e vlefshme vetem me aprovimin unanim te te gjithe ortakeve.
NENI 8	<u>ADMINISTRIMI</u>
8/1	1. Administrator i shoqerise emerohet Armando Ndreu i biri i Ndreut dhe i Zojes , lindur ne Gjegjan-Puke dhe banues ne Tirane , i datelindjes 24 Shtator 1990, me Id J 00924101 J dhe emerohet per nje periudhe 5 vjecare nga krijimi i shoqerise. 2. Administratore e shoqerise emerohet Anarilda Bregu,e bija e Nazmiut dhe Habibes,lindur ne Poliçan-Skrapar dhe banuese ne Tirane,e datelindjes 30 Nentor 1989 me Id I 96130006 A per nje periudhe 5 vjecare nga krijimi i shoqerise.
8/2	-Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim te ortakeve , qe perfaqesojne me teper se ½ te pjeseve te kapitalit themeltar.
8/3	- Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve. Ai mund te kryej operacione pagesash deri ne nje limit prej 25.000 euro. Mbi kete limit duhet miratimi i Asamblese se ortakeve.
8/4	-Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratoreve dhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektet e shoqerise. Ajo nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqerise.
8/5	-Administratoreve nuk i lejohet te marrin hua nga shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj per paradhenie, si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj, angazhimin ndaj te treteve.
8/6	-Administratoret jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.
8/7	-Pervec padise per shlyerjen e demit qe u ngarkohet personalisht, ortaket, individualisht ose ne grup, kane te drejte te ngrrene padi penale kunder administratoreve.
8/8	-Administratoret shkarkohen me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e kapitalit themeltar. Administratoret shkarkohen nga gjykata per shkelje te ligjit, me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.
8/9	-Raporti i administrimit, inventaret, dhe llogarite vjetore te hartuara nga administratoret, i nenshtrohen miratimit te asamblese se ortakeve, brenda 6 muajve duke filluar nga data e e mbylljes se vitit finanziar.
NENI 9	<u>ASAMBLEJA E PERGJITHSHME</u>

9/1	<p>Asambleja e Pergjithshme eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per ceshtjet me poshteme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Percaktimin e politikave tregetare te shoqerise me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres; - Ndryshimet e statutit me 65 % te votave te ortakeve pjesemarres ne kapitale - Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve te shoqerise me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres ne kapitale. - Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar shoqerise me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres ne kapitale. - Miratimin e pasqyrave financiare vjetore te shoqerise me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres ne kapitale. - Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit me 3/5 e votave te ortakeve pjesemarres ne kapitale. - Perfaqsimin e shoqerise ne gjykate; - Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise me 3/5 e votave te ortakeve pjesemarres ne kapitale. - Miraton fillimin e procedurave te falimentimit te shoqerise. - Asambleja mund te vendose ne prezencen e ortakeve ne vende te ndryshme qe te jete e garantuar, video konference, telekonference duke perfshire edhe teknologjite e tjera ne cdo moment me te gjitha te drejtat: <ul style="list-style-type: none"> o Mundesa e identifikimit reciprok. o Aftësia për të parë, të marrë dhe të transmetojë të gjitha documentacione lidhur ose në lidhje me rendin e ditës, me mundësinë e shqyrtimit kontekstual. o Pjesmarrja ne diskutim dhe ne te drejten e votes. o Mbledhja e asamblese konsiderohet e vlefshme njesoj kur mbahet ne vendin qe ndodhet presidenti dhe sekretari. Procesverbali do te nenshkruehet nga presidenti me ndihmen e sekretarit.
9/2	<p>-Mbledhja e zakonshme e Asamblese te Pergjithshme thirret te pakten 1 here ne vit. Njoftimi behet me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbane vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet ortakeve jo me vone se 15 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.</p>
9/3	<p>Asambleja Pergjithshme thirret nese ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.</p>
9/4	<p>- Asambleja Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese ose disponoje aktive qe kane nje vlore me te larte se 5% te aseteve te shoqerise.</p>
9/5	<p>- Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj, propozon te blej nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5% te aseteve te shoqerise.</p>
9/6	<p>- Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike, i cili duhet te permbane vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites, e tu dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.</p>
9/7	<p>- Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne mbi 50% te kuotave. Ne rastin kur Asambleja Pergjithshme duhet te vendos per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket zoterojne mbi 65 % e numrit total te kuotave qe jane te pranishem personalisht.</p>
9/8	<p>Asambleja vendos per :</p> <ul style="list-style-type: none"> - blerje, kalime, shkembime te pasurise se paluajtshme

	<ul style="list-style-type: none"> - nenshkrim kontratash leasing - leshime garancie - marrje huash
NENI 10	VITI FINANCIAR – NDARJA E FITIMEVE
10/1	-Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.
10/2	- Nga fitimi i realizuar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e viti themelues se meparshem, lihet menjane nje shume sa 1/20 e tij, e cila quhet “Rezerve e Domosdoshme” dhe mbaron kur kjo shume arrin 1/10 e kapitalit themelues.
10/3	<ul style="list-style-type: none"> - Shoqeria mund te shperndaje fitime ortakeve vetem nese pas pagimit te dividentit : a) Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet; b) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim; c) Administratori leson nje certifikate te aftesise paguese.
NENI 11	LIKUIDIMI
11/1	-Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj dhe pasohet nga shenimi “Shoqeri ne likuidim e siper”. Shoqeria ekziston si person juridik per nevojat e likuidimit deri ne momentin e perfundimit te ketij procesi.
11/2	-Likuiduesi emerohet ne rast se prishja rrjedh nga perfundimi i afatit te percaktuar ne statut, ose n.q.s prishja vendoset nga ortaket, me pelqimin e shumices per nga kapitali i ortakeve.
11/3	-N.q.s ortaket nuk kane mundur te emerojne nje likuidues, ose prishja e shoqerise eshte bere me vendimte gjyqi, gjykata cakton likuidatorin.
11/4	-Likuiduesi perfaqeson shoqerine dhe ka te gjitha kompetencat per shitjen e aktivit, per pagimin e kreditoreve.
11/5	-Likuiduesi harton brenda tre muajve nga mbyllja e cdo viti financiar llogarite vjetore per operacionet e likudimit gjate viti financiar te kaluar.
11/6	-Ndarja e kapitaleve te veta qe mbeten pas pagimit te pjeseve te kapitalit themelues behet ndermjet ortakeve ne perpjestim te njejtë me kontributin e tyre ne kapitalin themelues.
11/7	-Ortaket thirren ne fund te procesit te likuidimit, vendosin per bilancin financiar perfundimtar dhe per mbylljen e procesit te likuidimit. N.q.s mbledhja e asamblese nuk merr vendim ose nuk pranon te miratoje llogarite e likuiduesit, vendimi merret nga gjykata me kerkesen e likuiduesit, ose te cdo personi te interesuar.
11/8	-Gjykata merr vendim per llogarite dhe ne rast se eshte e nevojshme , per mbylljen e likuidimit.
NENI 12	MOSMARREVESHJET
12/1	-Zgjidhen me mirekuptim ndermjet ortakeve. Kur kjo nuk realizohet, ceshtja i kalon Gjykates se Rrethit Gjyqesor Perkates.

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohet ligji “Per shoqerite tregetare” dhe Legjislacioni Shqiptar.

Ky statut perpilohet ne 5 kopje.

O R T A K E T T H E M E L U E S

Armando NDREU Dorjan MYFTARI Anarilda BREGU